



Human Rights Review Panel

Buletini informativ nr. 15 - 1 nëntor 2016 deri me 31 mars 2017

- Seancat e fundit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Takim me shefen e Misionit të EULEX-it Kosovë
- Raporti vjetor 2016
- Emërimet gjyqësore në Dhomat e Specializuara nga shefja e Misionit të EULEX-it Kosovë
- Statistikat e lëndëve
- Seanca e ardhshme e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Seancat e fundit e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Seanca e 32-të e Panelit, 9-11 janar 2017

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) ka mbajtur seancën e 32-të nga data 9 deri me 11 janar 2017. Paneli ka marrë një (1) vendim mbi meritat, një (1) vendim të dytë mbi zbatimin e rekomandimeve të tij të mëhershme nga shefja e Misionit (ShM), dy (2) vendime mbi zbatimin e rekomandimeve të tij nga ShM-ja dhe dy (2) vendime mbi pranueshmërinë.

Në lidhje me këto vendime, duhet të theksohen pikat e mëposhtme. Paneli ka gjetur në lëndën nr. [2013-21 Thomas Rüsche kundër EULEX-it](#) se ka pasur shkelje të nenit 13, e drejta për zgjidhje efektive, e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, (Konventa) me 11 janar 2017.

Paneli ka rekomanduar që ShM-ja duhet të pranoj se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që iu ishin atribuar veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Më tutje ka rekomanduar që kopjet e Vendimit t'ju shpërndahen prokurorëve të EULEX-it.

Në një Vendim të dytë pasues, në lëndën nr. [2011-20 X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it](#), (rasti i romëve) Paneli ka konstatuar se ShM-ja nuk i kishte respektuar rekomandimet e tij në Vendimin e tij të datës 22 prillit 2015 dhe ka ftuar ShM-në që të njoftoj Panelin lidhur me progresin e mëtejshëm rreth kësaj çështje deri me datën 28 shkurt 2017.

Paneli ka konstatuar në Vendimin e përmendur më lartë se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, e drejta për mjet efektiv dhe në përputhje me rrethanat ka bërë rekomandimet e mëposhtme:

ShM-ja duhet t'i udhëzoj zyrtarët prokurorial kompetentë të EULEX-it që të bëjnë hetime me autoritetet e Kosovës nëse një hetim në këtë çështje ka qenë duke vazhduar dhe nëse po në çfarë faze të procesit tani qëndron çështja.

Pas marrjes së këtij informacioni, ShM-ja duhet t'i udhëzoj prokurorët e EULEX-it që të marrin në konsideratë nëse do të marrin përsipër përgjegjësinë e këtij rasti në përputhje me nenin 7(A) të Ligjit nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit që lidhet me mandatin e Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, siç është theksuar më lartë, në mënyrë të veçantë nevojën që Misioni të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesve. Paneli ka kërkuar nga ShM-ja t'i siguroj Panelit informacionin në fjalë deri me 15 qershor 2015.

Paneli më pas ka marrë një vendim mbi zbatimin e rekomandimeve të Panelit me datën 11 nëntor 2015 dhe ka marrë vendimin e tij të dytë të tillë me datën 10 janar 2017. ShM-ja ishte përgjigjur Panelit me 16 mars 2017 në lidhje me vendimin e tij të dytë si më poshtë:

ShM-ja ka njoftuar Panelin se kryeprokurori i EULEX-it (KPE) i kishte shkruar kryeprokurorit të Shtetit (KPSH) me 6 shkurt 2017 për t'ia kujtuar KPSH rekomandimet e përfshira në Vendimin e Panelit. KPE ka njoftuar KPSH se në rrethanat e rastit parashkrimi nuk duhet të zbatohet dhe duhet të merret parasysh kryerja e hetimeve të mëtejshme për të vendosur nëse ishte kryer ndonjë vepër penale. KPE ka sugjeruar se hetimet e tilla mund të vërtetojnë nëse ka pasur ndonjë palë të dëmtuar dhe nëse po të merret dëshmia mjekësore prej tyre. Gjithashtu është sugjeruar se mund të dorëzohet në UNMIK kërkesa për heqjen e imunitetit të dokumenteve që kanë të bëjnë me rastin.

ShM-ja ka shtuar se KPSH kishte informuar KPE me datën 28 shkurt 2017 se shumë shpejt do të merrej një vendim për të ndërprerë hetimin për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit që është zbatuar për veprën penale të "shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm". ShM-ja ka informuar Panelin se ajo do të shqyrtojë aktvendimin e përmendur pasi ta merr atë dhe pastaj do të përcaktoj se çfarë ishin hapat e mëtejshëm, nëse ka, që EULEX-i mund të jetë në pozitë që të ndërmerret në bazë të rrethanave.

Paneli ka konstatuar në lëndën nr. [2014-18 Fitim Maksutaj kundër EULEX-it](#) dhe në lëndën nr. [2014-37 Y.B. kundër EULEX-it](#) se ShM-ja i kishte zbatuar rekomandimet e tij vetëm pjesërisht dhe kishte vendosur ta mbyllte shqyrtimin e këtyre rasteve.

Paneli ka gjetur në lëndën nr. [2014-18 Fitim Maksutaj](#) me 12 nëntor 2015, se ka pasur shkelje të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe ka bërë rekomandimet e mëposhtme:

ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit dhe duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të kryer një shqyrtim se çfarë hapash mund të ndërmerren nga Zyra e Prokurorit të EULEX-it (ZKPE) për të siguruar se rastet nën autoritetin e kësaj Zyre trajtohen në përputhje me dispozitat e nenit 6(1) të Konventës. ShM-ja duhet gjithashtu të sigurojë që të vendoset një mekanizëm efektiv shqyrtimi në mënyrë që të gjitha rastet e tilla të trajtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe Paneli të rrethojë vëmendjen drejt faktit se kur ky rast konkret ka qenë objekt i një shqyrtimi nga ana e ZKPE, k rast kishte ardhur në përfundim të shpejtë.

Paneli ka vënë re hapat e ndërmarrë nga ShM-ja që t'i ndjek rekomandimet e tij, në veçanti, që Misioni ishte duke shqyrtuar se si në mënyrën më të mirë t'i zbatoj standardet efektive për shqyrtimin e rasteve të trajtuara nga prokurorët e EULEX-it. Megjithatë, Paneli më tej ka vënë në dukje se ShM-ja nuk ka bërë ndonjë deklaratë, të çfarëdo forme, që të pranoj se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i ishin atribuar veprimeve të EULEX-it Kosovë.

Në lëndën nr. [2014-37 Y.B. kundër EULEX-it](#) Paneli ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës dhe ka bërë rekomandimet e mëposhtme për ShM-në:

ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. ShM-ja duhet t'i ofroj një kopje të këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it në mënyrë që t'i informoj ata rreth natyrës së përgjithshme të obligimit që ta kenë prioritet mbrojtjen e të drejtave dhe lirive jo vetëm të të dyshuarve dhe të akuzuarve, por edhe të personave të përfshirë në lëndët që ata i hetojnë.

Paneli ka vënë re hapat e ndërmarrë nga ShM-ja për të zbatuar rekomandimet e tij në këtë rast, dhe ka konstatuar se megjithatë ShM-ja nuk ka bërë ndonjë deklaratë, të çfarëdo forme, ku pranoj se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut që i ishin atribuar veprimeve të EULEX-it Kosovë.

Paneli ka konstatuar se lënda nr. [2014-10 J.Q. kundër EULEX-it](#) dhe lënda nr. [2015-04 Nazmi Maloku kundër EULEX-it](#) ishin të papranueshme.

Seanca e 33-të e Panelit, 6-8 mars 2017

Paneli ka marrë një (1) vendim të dytë pasues mbi zbatimin e rekomandimeve të tij të mëhershme nga shefja e Misionit (ShM), dy (2) vendime të para pasuese mbi zbatimin e rekomandimeve të tij nga ShM-ja dhe nëntë (9) vendime mbi papranueshmëri.

Paneli ka konstatuar se ka pasur shkelje të neneve 2 dhe 3 dhe të nenit 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës në vendimin e tij të datës 19 tetorit 2016 në lëndët nr. [2014-11 to 2014-17, D.W.; E.V.; F.U.; G.T.; Zlata Veselinovic; H.S. dhe I.R. kundër EULEX-it](#) dhe ka bërë rekomandimet si në vijim:

ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses, t'ju komunikojë dhe transmetojë këtë vendim të gjitha organeve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të EULEX-it; Misioni të komunikoj me të afërmit e viktimave me shpejtësinë, zellin e duhur dhe kujdesin e nevojshëm dhe të zbatojnë udhëzimet për këtë lloj komunikimi. ShM-ja gjithashtu duhet të nënvizoj rëndësinë që lëndët, të cilat kanë të bëjnë me personat e zhdukur me forcë të vazhdojnë të jenë prioritete të hetimeve dhe që EULEX-i të ketë burime të nevojshme dhe mbështetje për të përmbushur misionin e tyre në mënyrë efektive dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut të të gjithë të përfshirëve, posaçërisht të drejtat e garantuara me nenin 2 dhe 3 të Konventës.

ShM-ja më tej ishte ftuar t'i këshillonte autoritetet kompetente hetuese dhe prokuroriale të EULEX-it që t'i renditnin faktorët në Vendim si relevante në vlerësimin e kompetencës "jashtëzakonshme" të prokurorëve të EULEX-it në bazë të nenit 7(A) të Ligjit të rishikuar mbi kompetencat.

ShM ka informuar Panelin me datën 29 nëntor 2016 se ajo do të komunikojë vendimin organeve përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit, në veçanti prokurorëve të EULEX-it, të cilët janë përgjegjësit e fundit për vlerësimin nëse ka pasur apo jo rrethana të jashtëzakonshme që do të arsyetonte marrjen e përgjegjësisë për një rast të veçantë.

ShM-ja po ashtu ka informuar Panelin se ajo kishte miratuar themelimin e një Rrjetin Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të shërbyer si mekanizëm për të drejtat kryesore të njeriut në zbatimin e mandatit të misionit, si dhe për të kryer një rishikim të procedurave dhe udhëzimeve që ndërlidhen me të. Ajo më tej ka deklaruar se do të përcjellë, përmes Komandantit të Operacioneve Civile, vendimin e Panelit tek shtetet anëtare, të cilët ishin përgjegjësit e fundit për caktimin e burimeve të Misionit.

Paneli ka deklaruar me datën 7 mars 2017 se ShM-ja kishte zbatuar rekomandimet e tij në këtë lëndë vetëm pjesërisht, dhe mirëpret përpjekjen e ShM-së që t'i ofroj Panelit rezultatet e rishikimit të brendshëm të procedurave dhe udhëzime në kohën e duhur.

Lënda nr. [2014-32 L.O kundër EULEX-it](#)

Paneli ka konstatuar në vendimin e tij të datës 11 nëntor 2015 se EULEX-i Kosovë kishte shkelur nenet 2 dhe 3 (pjesët procedurale) dhe nenet 8 dhe 13 të Konventës dhe ka bërë rekomandimet e mëposhtme:

ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses; t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit, të cilët janë në kontakt me viktimat e supozuara të shkeljes së të drejtave (ose të afërmeve të tyre) që të sigurojnë se në të gjitha komunikimet me ta të komunikohet me masën e nevojshme të shpejtësisë, zellit dhe kujdesit të domosdoshëm; të siguroj që të gjitha organet hetuese në kuadër të Misionit (Task Forca e Hetimeve Speciale (TFHS) dhe prokurorët e EULEX-it) kanë në dispozicion burimet e nevojshme dhe mbështetje për të përmbushur misionin e tyre.

ShM-ja duhet të kërkoj që të qartësohet marrëdhënia midis Misionit dhe TFHS-së me qëllim që të sigurohet mbrojtja efektive e të drejtave dhe garancitë; të sigurojë informata të duhura dhe të mjaftueshme për ankuesit; t'iu bëjë të ditur TFHS-së dhe shteteve rëndësinë që rastet e tilla duhet të hetohen në mënyrë të plotë dhe efektive dhe t'iu bëjë të ditur TFHS-së rëndësinë dhe nevojën për t'i njoftuar viktimat rreth aspekteve të përgjithshme të hetimeve të tyre.

ShM-ja në largim i është përgjigjur Panelit përmes letrës së datës 29 prill 2016 në lidhje me rekomandimet në vendimin e 11 nëntorit 2015 si më poshtë:

Përderisa rekomandimet e Panelit kanë të bëjë me masat që janë në dispozicion të Planifikimit Civil dhe Aftësi të Udhëheqjes (PCAU), disa institucioneve të BE-së, si dhe shteteve anëtare, kam informuar PCAU-në dhe shtetet kontribuuese rreth vendimit të Panelit përmes komandantit të Operacioneve Civile dhe kështu konsideroj që rekomandimet janë zbatuar.

Paneli ka marrë një **Vendim mbi zbatimin e rekomandimeve të tij me datën 19 tetor 2016** dhe ka konstatuar se përkundër asaj çfarë deklarata e mësipërme e ShM-së duket se sugjeron, përgjegjësia për t'i jetësuar dhe zbatuar rekomandimet e Paneli bie tërësisht dhe ekskluzivisht mbi ShM-në, e jo mbi PCAU e as mbi shtetet anëtare. Në këtë kuptim, përderisa ShM-ja mund të vendosë, në një rast të veçantë, për të kërkuar ndihmën e organeve të tjera në kuadër të EULEX-it për të zbatuar rekomandimet, përgjegjësia për zbatimin e tyre në fund mbetet mbi ShM-në. Rrjedhimisht, Paneli ka deklaruar se ish-ShM-ja nuk i kishte zbatuar rekomandimet dhe ka kërkuar nga ShM-ja e re të shqyrtoj dhe zbatoj në mënyrë të plotë secilin rekomandim të Panelit dhe si përgjigje të informojë Panelin lidhur me veprimet e ndërmarra sa më shpejt që është e mundur.

ShM-ja e re është përgjigjur me datën 8 dhjetor 2016 ndaj Vendimit të Panelit mbi zbatimin e rekomandimeve të tij të datës 19 tetorit 2016. Ajo ka deklaruar se në lidhje me rekomandimin e parë

të Panelit, nuk ishte politika e Misionit që shprehimisht t'u pranoi ankuesve se EULEX-i kishte shkelur të drejtat e tij/saj të njeriut. Në lidhje me rekomandimin e dytë, ajo ka njoftuar se kishte miratuar krijimin e Rrjetit Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar zbatimin e të drejtave të njeriut nga ana e Divizioneve të EULEX-it. Në lidhje me rekomandimet e tjera, ajo iu ishte referuar Panelit në përgjigjen e ShM-së në largim të datës 29 prill 2016 dhe ajo nuk ka parë asnjë arsye që të largohet nga pikëpamja e shprehur aty.

Paneli ka marrë Vendimin e dytë mbi zbatimin e rekomandimeve të Panelit me datën 7 mars 2017. Paneli ka vënë në dukje me keqardhje se kjo ka qenë praktikë e vazhdueshme e Misionit që të refuzojë apo që mos të pranoi zyrtarisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, ku Paneli ka konstatuar se kjo kishte ndodhur.

Në lidhje me rekomandimin e tij të dytë në komunikimet me ankuesin, Paneli ka vënë në dukje me kënaqësi nismën e ShM-së për të themeluar një Rrjetit Kontaktues për të Drejtat e Njeriut në mënyrë që të sigurohet respektimi i të drejtave të njeriut nga ana e Divizioneve të EULEX-it.

Në lidhje me pjesën tjetër të rekomandimeve të Panelit, ShM-ja ka deklaruar si në vijim:

“... I referohem përgjigjes nga paraardhësi im i datës 29 Prill 2016, dhe nuk ka parë ndonjë arsye që të largohet nga pikëpamja e shprehur aty. Kjo është mbështetur nga Këshilli i Përbashkët i Veprimit 2008/124/CFSP, ndryshuar me Vendimin e Këshillit 2014/685/CFSP të datës 19 shtator 2014 dhe Vendimin e Këshillit 2016/947/CFSP i datës 14 qershor 2016, të cilat përcaktojnë se EULEX-i do të mbështesë procedurat gjyqësore të zhvendosura brenda shteteve anëtare. Megjithatë, shtetet anëtare kanë miratuar themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorëve Special (DhS&ZPS) që është plotësisht e pavarur nga EULEX-i. Ligji nr. 05/L-053 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 3 gusht 2015, përcakton se ZPS-ja do të marrë përsipër mandatin dhe personelin e TFHS-së dhe “do të jetë zyre e pavarur për hetimin dhe ndjekjen e krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara”. Përveç kësaj, shtetet anëtare kanë vendosur që DhS&ZPS do të jetë përgjegjës ndaj një Ombudspersoni të veçantë, dhe në mënyrë specifike i përjashton të dy DhS&ZPS nga juridiksioni i Panelit. Prandaj nuk mund të ushtrohet presion mbi ZPS-në&DhS-në nga EULEX-i siç sugjerohet nga rekomandimi. Prandaj nuk jam në gjendje t'i zbatojë rekomandimet e Panelit”.

Paneli vënë re mendimin e ShM-së se ajo nuk është kompetente dhe nuk ka autoritet për të ngritur dhe adresuar rekomandimet e Panelit tek THFS-së, DhS-së&ZPS-së apo tek shtetet që mbështesin institucionin e ri. Bazuar në konsideratat e mësipërme, Paneli është i kënaqur se ShM-ja i ka dhënë vëmendjen e duhur rekomandimeve të tij dhe i ka dhënë një përgjigje të duhur shumicës së këtyre rekomandimeve.

Paneli ka deklaruar se ish ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e tij në këtë rast vetëm pjesërisht, ka përshëndetur përpjekjen e ShM-së për të njoftuar Panelin rreth rezultatit të rishikimit të brendshëm dhe ka vendosur të mbyllë shqyrtimin e këtij rasti.

2014-34 Rejhane Sadiku Sylja kundër EULEX-it

Paneli ka konstatuar në këtë lëndë me datën 19 tetor 2016 se EULEX-i Kosovë kishte shkelur nenet 2 dhe 3, dhe nenin 13 në lidhje me nenin 2 të Konventës; dhe ka bërë rekomandimet në vijim:

ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë që pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses; të komunikojë dhe transmetojë këtë vendim tek të gjitha organet përkatëse hetimore dhe prokuroriale të Misionit dhe të miratojë udhëzimet për komunikime të tilla. ShM-ja duhet që gjithashtu të nënvizojë rëndësinë e rasteve të zhdukjeve që vazhdojnë të jenë prioritet i

hetimeve në mënyrë që ato të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe duhet të bëjë një deklaratë ku pranon se rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankueses; duhet t'i udhëzoj të gjitha organet e Misionit që janë në kontakt me viktimat e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës në kuadër të zhdukjeve të detyruara që të sigurohet se në të gjitha komunikimet me ta, ata të komunikojnë me shpejtësinë, zellin e duhur dhe kujdesin e nevojshëm për të marrë parasysh shqetësimin emocional të bashkëbisedues(ve)it të tyre; dhe duhet të sigurojnë që autoritetet hetimore të EULEX-it të kenë burimet e nevojshme për të arritur misionin e tyre.

ShM-ja për më tepër ishte ftuar që t'i njoftoj autoritetet kompetente hetuese dhe prokuroriale të EULEX-it rreth faktorëve të renditura në këtë vendim si të rëndësishme për vlerësimin e kompetencës "së jashtëzakonshme" të prokurorëve të EULEX-it në bazë të nenit 7(A) të rishikuar të Ligjit mbi Juridiksionin dhe për ta vlerësuar rëndësinë e marrjes së këtyre faktorëve në konsideratë në vlerësimin e tyre nëse duhet të kërkojnë që të marrin përsipër përgjegjësinë për këtë rast. ShM-ja ishte ftuar që të informoj Panelin rreth masave që ajo ka ndërmarrë në lidhje me këtë vendim jo më vonë se me datën 19 nëntor 2016.

Një shqyrtim i brendshëm i procedurave dhe udhëzimeve që tani janë në zbatim do të jenë pjesë e këtij procesi dhe do ta informoj Panelin rreth rezultateve të këtij shqyrtimi të brendshëm.

ShM-ja në letrën e saj të datës 28 nëntor 2016 ka deklaruar si më poshtë;

"Një kopje e vendimit të Panelit i është ofruar prokurorëve të EULEX-it. Përveç kësaj, unë kam miratuar krijimin e një Rrjeti Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar përputhshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e divizioneve. Një rishikim i brendshëm i procedurave dhe udhëzimeve do të jetë pjesë e këtij procesi dhe unë do të informoj Panelin rreth rezultateve të rishikimit të brendshëm.

Disa prej rekomandimeve të Panelit kanë të bëjnë me masat që janë nën kompetencë të Planifikimit Civil dhe Aftësi të Udhëheqjes (PCAU), disa institucioneve të BE-së, si dhe shteteve anëtare. Unë kam informuar PCAU-në dhe shtetet kontribuuese rreth vendimit dhe gjetjet e Panelit përmes Komandantit të Operacionit Civil. Më tej, do të doja të theksoj se prokurorët e EULEX-it janë të informuar mirë me rregullat dhe rregulloret në fuqi në lidhje me "rrethanat e jashtëzakonshme" të përcaktuara nga neni 7 (A) i Ligjit të ndryshuar mbi Kompetencat".

Paneli ka marrë Vendimin mbi zbatimin e rekomandimeve të tij me datën 7 mars 2017. Lidhur me rekomandimin e tij të parë se rrethanat e lëndës kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit, Paneli ka vërejtur me keqardhje se kjo ka qenë praktikë e vazhdueshme e Misioni që të refuzoj apo që të mos pranoj zyrtarisht përgjegjësinë për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit ku Paneli ka konstatuar se kjo kishte ndodhur.

Paneli ishte i kënaqur që ShM-ja ka ndërmarrë hapa efektive për të zbatuar rekomandimin e tij që vendimi dhe gjetjet e tij të dërgohen tek të gjitha organet përkatëse. Paneli gjithashtu ka përgëzuar ShM-në në lidhje me vendimin e saj që të themeloj Rrjetin Kontaktues për të Drejtat e Njeriut për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut nga Divizionet e EULEX-it. Paneli gjithashtu kishte rekomanduar se ShM-ja duhet t'ju theksoj organeve hetimore të EULEX-it rëndësinë që rastet e zhdukjeve të vazhdojnë të jenë prioritet i hetimeve. Përderisa ShM-ja nuk ka adresuar shprehimisht këtë rekomandim, vendimi i Panelit është komunikuar në mënyrë të rregullt tek prokurorët e EULEX-it kështu që Paneli është i kënaqur se shqetësimi i tij ishte përcjellë në mënyrë të rregullt tek organet kompetente të Misionit.

Prandaj, Paneli ka deklaruar se ShM-ja kishte zbatuar rekomandimet e tij në këtë lëndë vetëm pjesërisht dhe ka përshëndetur ndërmarrjen nga ana e ShM-së për të njoftuar Panelin rreth rezultatit të rishikimit të brendshëm që tani është duke u bërë dhe ka vendosur ta mbyllë shqyrtimin e kësaj lënde.

Paneli ka konstatuar se ankesat kanë qenë të papranueshme në lëndët e mëposhtme: [2014-35](#); [2015-06](#); [2015-11](#); [2015-12](#); [2015-15](#); [2016-01](#); [2016-02](#); [2016-04](#); dhe [2015-05](#).

Takimi me shefen e Misionit të EULEX-it Kosovë

Paneli është takuar me znj. Alexandra Papadopoulou, shefe e Misionit, e shoqëruar nga znj. Elaine A Paplos, znj. Marianne Fennema dhe znj. Valentina Vitali në ndërtesën e PShDNj-së me 7 mars 2017. Nëndin e ditës ishte diskutimi lidhur me numrin e lëndëve aktuale të Panelit dhe ndikimi i tyre në burimet e reduktuara njerëzore të Sekretariatit për shkak të rikonfigurimit të stafit të EULEX-it në vitin 2016. Aty janë zhvilluar diskutime po ashtu edhe rreth personave të vrarë dhe të zhdukur, pra rreth zhdukjeve me forcë gjatë konfliktit të armatosur pas qershorit të vitit 1999. Po ashtu janë diskutuar edhe kushtet e referencës së propozuar të Rrjetit Kontaktues për të Drejtat e Njeriut.



Nga e majta në të djathtë: (Noora Aarnio nuk shihet ne foto), Guenael Mettraux, Elka Ermenkova, Madga Mierzewska, Anna Bednarek, John J Ryan, Marianne Fennema, Alexandra Papadopoulou, Valentina Vitali, Elaine A Paplos

Raporti vjetor 2016

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka publikuar dhe shpërndarë Raportin Vjetor të vitit 2016 të premten me datën 24 mars 2017. Raporti ofron informata lidhur me lëndët që Paneli i ka shqyrtuar gjatë gjithë periudhës raportuese, lëndën e ankesave dhe informacionin rreth zhvillimeve të fundit në juridiksionin e Panelit. Gjithashtu aty ofrohen informata rreth aktiviteteve të tjera të Panelit, siç janë takimet e brendshme dhe të jashtme në të cilat është angazhuar, si dhe informacione rreth fushatës publike. Raporti vjetor përfundon me një segment mbi konkluzionet dhe rekomandimet e tij në fund të raportit.

Raporti mund të shihet në faqen e internetit të Panelit në: www.hrrp.eu dhe është shpërndarë në mënyrë elektronike tek shumë dërgues.

Emërimet gjyqësore në Dhomat e Specializuara dhe në Zyrën e Prokurorëve Speciale

Znj. Alexandra Papdopolou, shefe e Misionit, EULEX-i Kosovë ka emëruar dy anëtarë të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it si dhe një ish-anëtar të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut si gjyqtarë në Dhomën e Specializuara në Hagë, Holandë, me 7 shkurt 2017 (shikoni më poshtë). Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorisë Speciale, Ligji Nr. 05 L/-53, ishte shpallur me dekretin nr. DL-027-2015 në gusht 2015. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorisë Speciale kanë juridiksion mbi krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera sipas ligjit të Kosovës në lidhje me akuzat e raportuara në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të datës 7 janar 2011, kryesisht lidhur me krimet e luftës të kryera nga ish formacioni paramilitare të shqiptarëve të Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Dr. Guenaël Mettraux

Dr. Guénaël Mettraux është emërua gjykatës në Dhomat e Specializuara me datën 7 shkurt 2017. Ai është anëtar i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut që prej datës 30 shtator 2012. Dr. Mettraux është shtetas zviceran dhe ka licencë nga Universiteti i Lausanne (Zvicër), LLM nga University College London dhe ka titullin doktor i shkencave nga Shkolla e Ekonomisë dhe Shkencave Politike në Londër.

Dr. Mettraux punon si avokat dhe konsulent pranë gjykatave penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdemit (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut (Zvicër).

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës penale ndërkombëtare. Veprat e tij shkencore përfshijnë tre libra: *Krime ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc* (Shtëpia botuese Oxford University Press, 2005), *Perspektivat në gjykimin në Nuremberg* (Shtëpia botuese Oxford University Press, 2008), dhe *Ligji i përgjegjësisë për komandim* (Shtëpia botuese Oxford University Press, 2009), e cila kishte fituar çmimin Lieber nga Shoqata amerikane e së Drejtës ndërkombëtare. Dr. Mettraux është anëtar i Komitetit Redaktues i Revistës së Drejtësisë Penale Ndërkombëtare dhe Këshillit të Redaktorëve të Revistës së Ligjit Penal Ndërkombëtar.

Gjykatësi Antonio Balsamo

Gjykatësi Antonio Balsamo, nga Italia, është emërua gjithashtu si gjykatës ndërkombëtar në Dhomat e Specializuara në Hagë, Holandë, me 7 shkurt 2017. Ai ka shërbyer si kryesues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it në Kosovë nga maji i vitit 2010 deri në maj të vitit 2012.

Ai ka shërbyer zëvendësprokuror i përgjithshëm i Gjykatës Supreme të Kasacionit të Italisë dhe profesor i të drejtës penale në fakultetin juridik të LUMSA-s në Palermo. Nga 2011 deri më 2016, ai ishte kryetar i gjykatës së qarkut në Kaltaniseta (Caltanissetta). Nga 2007 deri më 2011, u vu në shërbim të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Italisë si gjykatës dhe nga 1992 deri më 2007 ka punuar gjykatës në gjykatën e Palermos. Nga maji 2010 deri në maj 2012, gjykatësi Balsamo ka shërbyer si kryesues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it në Kosovë.

Gjykatësi Balsamo ka marrë pjesë si ekspert dhe këshilltar në projektet e BE-së për reformën e Kodit Penal të Bullgarisë, themelimin e Zyrës së Prokurorit Publik në IRJM për luftën kundër krimin të

organizuar dhe korrupsionit, dhe në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në Turqi. Gjykatësi Balsamo ka qenë anëtar i komisioneve dhe këshillave të ndryshëm gjyqësorë në Itali.

Gjykatësi Balsamo është diplomuar si jurist në Universitetin e Palermos (Itali) ku edhe është specializuar për të drejtën e administrimit rajonal dhe lokal. Më 1991, ai u emërua praktikant për gjykatës. Ai ka botime të shumta për tema të ndryshme mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel vendor dhe ndërkombëtar, si edhe për të drejtën penale.

Gjykatësi Michele Picard


Gjykatësja Michele Picard (Mishelë Pikar) (Francë) ishte emërua gjithashtu si gjykatëse ndërkombëtare në Dhomat e Specializuara, Hagë, Holandë, me 7 shkurt 2017. Ajo ka shërbyer si anëtare e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut nga janari 2007 deri në mars 2008.

Gjykatësja Michele Picard (Mishelë Pikar) (Francë) është gjykatëse e Gjykatës së Apelit në Paris që prej qershorit 2013. Nga 2008 deri më 2013, ajo ishte gjykatëse në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Nga 2007 deri më 2008, u emërua *anëtare e Panelit Këshillues për Të drejtat e Njeriut në Kosovë* dhe gjatë periudhës 1996-2003 ajo ka kryesuar Dhomën për të drejtat e Njeriut në Bosnjë-Hercegovinë. Në vitin 2005, ajo ishte emëruar eksperte e pavarur për Gjendjen e Të drejtave të Njeriut në Uzbekistan. Ajo gjithashtu ka punuar për Këshillin e Evropës si eksperte për projekte të përafritimit të legjislacionit vendor me atë evropian për të drejtat e njeriut në Maqedoni, Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë.

Gjykatësja Pikar është e diplomuar si juriste nga Universiteti i Parisit. Më 1992, ajo ka kryer shkollën për gjykatëse në Bordo (Bordeaux).

Statistika e lëndëve

Paneli ka shqyrtuar njëqind e pesëdhjetë e dy (152) lëndë prej se ka filluar punën e tij në qershor të vitit 2010. Paneli ka konstatuar se EULEX-i Kosovë ka bërë shkelje të të drejtave në njëzet e pesë (25) lëndë. Më tej është gjetur se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në njëzet e pesë (25) lëndë të tjera të cilat ishin konsideruar të pranueshme. Diku tridhjetë e shtatë lëndë janë parashtruar në Panel që nga 1 janari i vitit 2016 dhe tani për tani në Panel janë tridhjetë e shtatë (37) lëndë në pritje.



Seanca e radhës së Panelit

Seanca e radhës së Panelit është caktuar të mbahet nga data 29 maj deri me 31 maj 2017.

Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu



SI TË PARASHTROHET ANKESA NË PSHDNJ

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga Misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrahet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrahet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrahet në:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrahet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtë (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.